



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E DREJTËSISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT  
ZYRA E PERMBARIMIT KORCE**

Nr. 3627 prot.

Korcë, më 13.12.2018

**L e n d a:** Shpallje për shitje të sendit të paluajtshëm në ankandin e parë

**Drejtuar:** (debitorit) z/znj. Muharrem Dino e Shqiponja Dino banues në Rr. »Partizani « pll.14,H/2,Ap.17,Korce

(kreditorit): z. Ramiz Xhengo banues në fshatin Dvoran, Rrethi Korce

Bashkise Korce, Rajonit Administrativ Nr.3(tre)  
Gjykatës Rrethi Gjyqësor Korce  
Drejtoria e Përgjithshme e Permbarimit Tirane  
Gazetes Panorama dhe Gazetes Shekulli

Bashkelidhur po ju dergojme për njoftim dhe afishim sipas ligjit Vendimin nr.3627 prot date 13.12.2018 për shpalljen e shitjes në ankandin e parë të pasurisë së paluajtshme të llojit Lloji "Truall" me nr.pasurie 7/48,Z.K.8564,vol.16,fq.51 me sipërfaqe prej 74.4 m2 ,e ndodhur në Rr."Liceistet", me ane të se cilit njoftojme se në datë 28.12.2018 ditën e Premte, ora 16.00 në ambjentet e Zyres së Permbarimit Korce, perfundon ankandi i parë , i cili është shpallur me datë 13/12/2018, për shitjen e sendit të paluajtshëm të debitoreve Muharrem Dino e Shqiponja Dino banues në Rr. »Partizani « pll.14,H/2,Ap.17,Korce për shlyerjen e detyrimit në favor të kreditorit Ramiz Xhengo.

Faleminderit për bashkëpunimin Tuaj

**KRYETARI**

**Olta SHKEMBI**

**Adresa:** Bul"Republika" Keshilli i Qarkut Korce

Tel/fax.082245621



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E DREJTËSISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT  
ZYRA E PERMBARIMIT KORCE**

Nr.3627 prot.

Korcë, më 13.12.2018

**V E N D I M**  
**(PER SHPALLJEN E SHITJES NE ANKAND TE PASURISE SE PALUAJTSHME )**

Une **Olta Shkempi** Permbaruese Gjyqesor prane Zyres Permbarimore Korce, pasi studiova materialet e dosjes permbarimore nr.74-017 date 13/02/2017 bazuar ne “Urdherin e Ekzekutimit” nr.195/2074 date 19/02/2016 te Gjykates Rrethit Gjyqesor Korce

**K O N S T A T O V A :**

Se ne datat 13/02/2017 eshte depozituar prane Zyres se Permbarimit Korce, kerkesa e (kreditorit) **Ramiz Xhengo** banues ne fshatin Dvoran, Korce se bashku me “Urdherin e Ekzekutimit” te titullit ekzekutiv vendimit gjyqesor nr.346, date 19.02.2016 te Gjykates Rrethi Gjyqesor Korce lene ne fuqi me vendimin nr.377 date 09.11.2016 te Gjykates Apelit Korce me pale:

**Kreditor : Ramiz Xhengo**

**Debitor : Muharrem Dino e Shqiponja Dino**

**Me objekt : Kthim shume prej 612.000 leke**

Lidhur me ekzekutimin e ketij vendimi kane filluar procedurat ligjore sipas neneve 517,519, 527, 560 e vijues te K.Pr.Civiledhe ligjit 8730 date 18/01/2001”Per Organizimin dhe Funkcionimin e Sherbimit Permbarimor Gjyqesor.

Me urdherin nr.74-017 Rregj,nr.415 prot date 25.04.2017 eshte vendosur sekuestro konservative ne pasurine e paluajtshme :

**-Llojit “Truall+Ndertese”nr/pas.7/48,Z.K.8564,vol.16,fq.51 me siperfaqe prej 74.4 m2 ,e ndodhur ne Rr.”Liceistet” Korce e rregjistruar ne Z.V.R.P.P.Korce ne emer te shtetasve debitore Muharrem Hasan Dino e Shqiponja Hysen Dino.**

**Adresa:Bul”Republika” Keshilli i Qarkut Korce**

**Tel/fax.082245621**

Me kerkese-padine i jemi drejtuar Gjykates Rrethit Gjyqesor Korce qe ne baze te nenit 578 te K.Pr.Civile te pjesteje dhe vecoje pjesen takuese te debitorit Muharrem Dino nga pasuria e paluajtshme ne bashkepronesi me shtetasen znj.Shqiponja Dino.

Me vendimin gjyqesor nr.274 date 05.03.2018 te Gjykates Rrethi Gjyqesor Korce eshte vendosur *“vecimi i pjeses takuese te debitorit Muharrem Dino per raportin e pjeses prej ½ dhe lenien e pasurise ne pronesi te paditures Shqiponja Dino,detyrimin e te paditures Shqiponja Dino te kompesoje vleren prej 317.576.4 leke te pjeses takuese te te paditurit (debitorit) Muharrem Dino,e cila duhet te derdhet brenda 10 diteve nga marrja forme te prere te ketij vendimi ne llogarine bankare te Zyres se Permbarimit Korce”*.

Me aktin teknik te ekspertimit eksperti vleresues z.Renato Cunoti ka percaktuar se vlera e pasurise se paluajtshme e llojit“Truall+Ndertese”nr/pas.7/48,Z.K.8564,vol.16,fq.51 me siperfaqe prej 74.4 m2 ,e ndodhur ne Rr.”Liceistet” eshte 635,152.8 lek,gjithashtu nga konstatimi i tij ne teren rezulton se kjo pasuri pavaresisht statusit ne dokumentat hipotekore “truall + ndertese,faktikisht ekziston vetem truall.

Ne zbatim te vendimit gjyqesor te sipercituar ,me shkresen nr.499 prot date 17.04.2018 i eshte kerkuar znj.Shqiponja Dino permbushja e detyrimit ne shumen 318.576.4 leke dhe ne rast se nuk permbushej detyrimi brenda afatit ligjor ,ne baze te nenit 568 te K.Pr.Civile do te shpallet ankandit.

Sipas akteve te administruara ne dosjen permbarimore,nuk rezulton te jete permbushur detyrimi nga debitori.

Ne zbatim te nenit 567 te K.Pr.Civile ,me shkresen nr.2198 prot date 18.09.2018 eshte lajmeruar znj.Shqiponja Dino se ne qofte se brenda 10 diteve te njoftimit nuk permbush detyrimin ndaj kreditorit,sendi i sekuestruar do te shitet ne ankand.

Me date 27.09.2018 ne Zyren e Permbarimit Korce eshte paraqitur znj.Shqiponja Dino e cila ka deklaruar se nuk do ta paguaj detyrimin (procesverbali date 27.09.2018)  
Cdo veprim i kryer nga ana jone per ekzekutimin e titullit ekzekutiv iu eshte komunikuar paleve,duke iu dhene te drejten e ankimit ne Gjykaten e Rrethit Gjyqesor Korce sipas ligjit

Per keto arsye:bazuar ne baze te neneve 568,569 e 570 te K.Pr.Civile, ligjit 8730 date 18/ 01/ 2001” Per Organizimin dhe Funkcionimin e Sherbimit Permbarimor Gjyqesor” dhe udhezimit nr.5 date 12.12.2012 “Per percaktimin e rregullave te hollesishme per zhvillimin e ankandit nga permbaruesi gjyqesor, une permbaruese gjyqesore Olta Shkembj

## **V E N D O S A:**

### **1-Shpalljen e shitjes ne ankand te pasurise,si me poshte:**

Lloji “Truall” me nr.pasurie 7/48,Z.K.8564,vol.16,fq.51 me siperfaqe prej 74.4 m2 ,e ndodhur ne Rr.”Liceistet”,Korce ne pronesi te Shqiponja Hysen Dino.

Me kete shpallje njoftoj te gjithë te interesuarit,duke i

INFORMUAR SE

1-Cmimi i sendit te paluajtshem qe shitet ka vleren prej 635,152.8 leke,si dhe cmimi fillestar ne ankandin e pare te hapur publik eshte 80 % (perqind) i cmimit te percaktuar sipas Raport –Vleresimit te ekspertit Renato Cunoti caktuar nga gjykata.

Vlera e sendit te paluajtshem eshte ne shumen prej 635,152.8 lek – 127,030.56 leke = 508,122.24,si dhe me kete vlere do te shpallet ne ankandin e pare te hapur publik,sipas dispozitave te K.Pr.Civile(neneve 568 dhe 570 te Kodit te Procedures Civile,si dhe udhezimit nr.5 date 12.12.2012 “Per percaktimin e rregullave te hollësishme per zhvillimin e ankandit nga permbaruesi gjyqesor.

2-Vendi ku do te zhvillohet ankandi i pare i hapur publik i shitjes se sendit eshte Zyra e Permbarimit Korce,e cila gjendet ne adresen,Bulevard “Republika” prane Keshillit te Qarkut Korce,kati i 4,Korce

3) Ankandi i pare i hapur publik per shitjen e sendit te paluajtshem shpallet sot me date 13.12.2018 dhe do te qendroje i publikuar deri ne date 28.12.2018,diten e Premte ora 16.00(afati 15-ditor nga e nesermja e shpalljes)

4)Dorezimi i kerkesave per pjesmarrje ne ankandin e hapur publik te pare do te pranohen ne te gjithë afatin 15-ditor(nga e nesermja) dhe procesi perfundimtar i zhvillimit te ankandit do te kryhet ne date 28.12.2018 ditën e Premte duke u mbyllur ne oren 16.00 me mbarimin e orarit zyrtar.

5)Cdo ofertues qe eshte i interesuar per blerjen e pasurise ne ankand ,eshte i detyruar te paraqitet personalisht dhe/ose nepermjet perfaqesuesit te tij/saj me prokure,si dhe te dorezoje (brenda ne zarf te mbyllur)ne zyren e permbarimit gjyqesor deri ne oren 16.00,keto dokumenta:

- a) Kerkesen e tij/saj per pjesmarrje ne ankand
- b) Faturen bankare te 10% te garancise per pjesmarje ne ankand(ne origjinal)
- c) Dokumentin e identifikimit(Karte identiteti ose Pasaporte)

6)Cdo ofertues qe merr pjese ne ankand,perpara fillimit te procedurave te shqyrtimit te ofertave ,ne datën 28.12.2018 ,ora 16.00,eshte i detyruar te depozitoje si garanci prane Bankes “Credins”Korce ne nr.llogarie 153916 te Zyres Permbarimit Korce nje shume te hollash te barabarta me 10% te cmimit te pasurise te caktuar ne shpallje.Kreditore nul le garanci,ne rast se kredia e tij e kalon masen e garancise.

7)Debitori dhe/ose perfaqesuesi i tij ligjor,permbaruesi gjyqesor,si edhe personat e tjere qe listohen ne nenin 709 te Kodit Civil,nuk kane te drejte te marrin pjese ne ankand.

8)Gazeta "Panorama" dhe Gazeta "Shekulli",sipas detyrimit qe rrjedh nga neni 568 i K.Pr.Civile,kete vendim detyrohen ta publikojne 5(pese) dite me rradhe,ne gazetate e tyre.Per sherbimin e kryer,pala kreditore merr persiper pagimin e shumes e cila me pas sipas nenit 525 te K.Pr.Civile i ngarkohet debitorit.

Ky vendim hartohet ne **10(dhjete)**kopje.1(Nje) kopje administrohet ne dosjen permbarimore **1(nje)** kopje afishohet ne ambjentet e Zyres Permbarimit Korce **1(nje)** kopje afishohet ne vendin ku ndodhet pasuria e paluajtshme;**1(nje)** kopje i njoftohet debitorit ; **1(nje)**kopje i njoftohet kreditorit; **2(dy)**kopje ju njoftohen Gjykates Rrethi Gjyqesor Korce dhe Bashkise Korce,per afishim ne ambjentet e tyre publike,**1(nje)** kopje dergohet ne Drejtorine e Pergjithshme te Permbarimit ; si dhe **2(kopje)**iu njoftohen per publikim,**Gazetes "Panorama"** dhe **Gazetes "Shekulli"**

**KRYETARE  
PERMBARUESE GJYQESORE**

**Olta Shkempi**